

Shpendët e Shqipërisë





*Empowered lives
Resilient nations*

Shpendët e Shqipërisë

Tiranë, 2018

Ky botim u realizua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, përmes projektit „Krijimi i Sistemit të Informacionit Mjedisor në Linjë me Raportimin Global“, në bashkëpunim me UNDP në vazhdimësi të përmirësimit të normave dhe standardeve në fushën e mbrojtjes së natyrës përmes përmirësimit të legjislacionit për Mbrojtjen e Faunës së Egër dhe Gjuetisë.

Fotografitë: Eno Gaçe

Hyrje

Peizazhi i larmishëm, pozicioni gjeografik, relievi i pasur, klima e favorshme në çdo stinë të vitit i kanë dhuruar Shqipërisë kushtet e përshatshme për të zhvilluar më së miri si florën, edhe faunën në vend.

Në një peizazh të tillë merr jetë një shumëllojshmëri shpendësh, të cilët janë pasuri me vlera të mëdha dhe të pazëvendësueshme për vendin tonë. Numri i tyre në Shqipëri arrin në rreth 370 lloje, nga të cilat rreth 290 lloje janë autoktone. Nga veriu në jug të Evropës e më tej në Afrikën Veriore e Azinë e Vogël mund të numërohen rreth 80 lloje shpendësh shtegtarë.

Lagunat bregdetare dhe liqenet e vendit tonë janë vendbanime të rëndësishme që ofrojnë kushtet e nevojshme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratore. Prej vitesh në këto mjedise hasen rreth **70 lloje shpendësh** uji, me një popullatë që arrin deri në **180.000 individë** gjatë dimrit.

Vlerat e shpendëve janë shumëdimensionale.

- Si një e dhënë për shëndetin e kushtet e një ekosistemi, pasi kanë vlera të pazëvendësueshme në ekuilibrin biologjik midis qenieve të gjalla duke penguar shtimin e madh të insekteve dhe dëmtuesve të ndryshëm,
- Si pasuri natyrore që vjen bashkë me zhvillimin ekonomik duke nxitur turizmin natyror të kombinuar me aktivitete të ndryshme që lidhen me kuriozitetin që ndjellin këta shpendë.
- Si harmonizim me natyrën, por edhe shkrirjen me botën njerëzore. Bota e pasur dhe e larmishme e shpendëve është e lidhur ngushtë me kulturën tradicionale të trashëguar në breza. Shpeshherë janë përdorur si burim frymëzimi duke i dhënë jetë shpirtit artistik të njerëzve.

Por a është në harmoni ky raport? Mungesa e ndërgjegjësimit dhe shfrytëzimi pa kriter po sjell përkeqësimin e raportit njeri-natyrë. Në Shqipëri gjenden rreth **91 lloje të kërcënuara në nivel global**, përfshirë këtu dhe Pelikanin kaçurrel (*Pelecanus crispus*).

Programi i qeverisë për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit me synim ndërmarrjen e masave parandaluese dhe ndaluese kundër shfrytëzimit pa kriter të faunës së egër, forcimin e sistemit të kontrollit dhe të parandalimit të dëmtimit si dhe rritjen e masave ndëshkimore kundër dëmtuesve po jep efektet e tij.

Larmia biologjike dhe ajo e peizazhit janë një pasuri, e cila, përveçse të shijohet nga vetë ne, mund të përdoret për të nxitur zhvillimin e turizmit. Nëse ne nuk jemi në gjendje dhe të përgjegjshëm për mbrojtjen e diversitetit biologjik dhe natyror, ekziston rreziku i humbjes së vlerave të tyre. Aktivitetet si shëtitjet në natyrë, ngjitjet në mal, gjuetia, peshkimi, si dhe aktivitete të tjera, atraktive për turizmin, kërkojnë që Shqipëria të mbrojë në mënyrë të vazhdueshme mjedisin dhe biodiversitetin e saj.

Për këtë arsye kërkohet rritja e ndërgjegjësimit me qëllim harmonizimin e raportit mes njeriut dhe natyrës.

Është e domosdoshme që me forma dhe metoda të ndryshme të rrisim dashurinë për shpendët që te fëmijët duke bërë të mundur ngritjen e sensibilizimit në breza. Të gjithë e shijojmë këtë pasuri dhe bukuri natyrore, por gjithashtu është edhe detyrë e të gjithëve ne ta duam, vlerësojmë e në mënyra të ndryshme ta mbrojmë dhe ta zhvillojmë këtë pasuri të pazëvendësueshme. Le t'u krijojmë habitatin e nevojshëm shpendëve të na e bëjnë jetën edhe më të larmishme e të bukur.





Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta

Pelikani kaçurrel

Pelecanus crispus

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Pelikani kaçurrel është një shpend i rrallë që haset në lagunat shqiptare. Pelikani konsiderohet si një ndër shpendët më të mëdhenj jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropë, duke tërhequr shpesh turistë dhe vendas, kureshtarë për të parë nga afër këtë ekzemplar që folezon kryesisht në lagunën e Karavastasë. Ajo çka të bie në sy te ky shpend

është sqepi – i stërmadh - në të cilin sheh të varet një xhep prej lëkure elastike që e lejon të kapë peshq për t'u ushqyer. Gjatësia e trupit të tij prej 160-180 cm dhe hapja e krahëve 270-320 cm e lejojnë të jetë tepër i zhdërvjellët në fluturim. Pelikani kaçurrel është një shpend fluturues karakteristik dhe mjaft interesant për liqenet e brendshme të Shqipërisë si: Shkodër,

Prespë e madhe dhe Prespë e Vogël. Vetëm në lagunën e Karavastasë folezon në koloni. Foletë i ndërton në ishuj, në ujëra të cekëta, të pasura me peshq, të mbrojtura nga njeriu dhe grabitqarët. Jo rrallëherë është rrezikuar shfarosja e tij dhe me të zhduket një vlerë jo vetëm natyrore, por edhe ekonomike. Le ta ruajmë një specie kaç të rrallë si Pelikani kaçurrel.





Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*), Parku Kombëtar Diçjakë - Karavasta








Çafka e vogël e bardhë *Egretta garzetta*

LAGUNA E FLLAKËS, DURRËS

Çafka e vogël e bardhë është një shpend mjaft elegant, i cili mund të kundrohet në lagunën e Fllakës në Durrës. Karakterizohet nga një trup i vogël, i hollë dhe me këmbë të zeza, të cilat kontrastojnë në skaje me ngjyrën e verdhë të shndritshme. Hapja e krahëve në fluturim shkon mes 49-58 cm duke hijeshuar tërë gjatësinë e tij prej 33-38 cm.

Çafka e bardhë është e kudondodhur, folezon në Evropë, por një pjesë e tyre dimëron edhe në Afrikë e në Lindjen e Mesme. Në Shqipëri kjo specie kaq interesante rrezikon të zhduket, motiv që ky shpend zgjedh të folezojë në koloni, në shkurre dhe pemë të dendura, në liqene të cekëta moçalorë, lumenj dhe laguna bregdetare.



Çafka e madhe e bardhë *Egretta alba*

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË KARAVASTA

Çafka e madhe e bardhë jeton në mjedise ujore bregdetare dhe kontinentale të cekëta. Zakonisht e hasim në Shqipëri gjatë periudhës së dimrit. Dallohet prej trupit të gjatë dhe në ngjyrë të bardhë. Karakteristikë e këtij shpendi është sqepi i verdhë në sezonin dimëror dhe i zi gjatë periudhës së riprodhimit. Këmbët i ka të verdha

dhe trupin 85-102 cm të gjatë, ndërsa gjatësinë e hapjes së krahëve e ka 140-170 cm. Kjo specie folezon në koloni, në fole të ndërtuara në grumbuj pyjorë buzë ujërave, si edhe nëpër kallamishte. Ushqehet me peshq, amfibë dhe insekte. Edhe pse konsiderohet një shpend i mbrojtur, Çafka e madhe e bardhë shpesh është në kërcënim për zhdukje.



Larushi kokëkuq

Lanius senator

BASHTOVË

Larushi kokëkuq është një shpend elegant për nga forma dhe pamja që të dhuron. Mashkulli i këtij shpendi ka shpinë të kuqërremtë, ndërsa femra dhe të vegjlit shpinën dhe pjesën e sipërme të krahëve e kanë në ngjyrë të kafenjtit. Me gjatësi mesatare 16-18 cm dhe gjatësi të hapjes së krahëve 24-27 cm, zakonisht pëlqen mjedise gjysmë të hapura me shkurre dhe pemë të rralla. Larushi kokëkuq folezon në zonën klimatike mesdhetare. Fole të ndërton në pemë ose në shkurre. Lëshon 5-6 vezë, të cilat çelin pas 15 ditësh dhe ushqehet kryesisht me insekte dhe larva. Si një gjallesë që nuk rrezikon zhdukjen, haset në vendin tonë kryesisht në Bashtovë.



Gargulli (bletëngrënësi) *Merops apiaster*

REZERVA NATYRORE KUNE-VAIN

Gargulli është një shpend migrator shumëngjyrësh. Mjaft interesant për t'u kundruar me kënaqësi, spikat me fytyrë të verdhë që ndahet nga gjoksi dhe barku blu i hapur nga një jakë e zezë. Kurorën, shpinën dhe një pjesë të krahut i ka ngjyrë gështenjë. Ky shpend fluturon me valëzime të shkurtra dhe të gjata. Gjatësia e trupit 25-29 cm dhe hapja e krahëve 42-46 cm ua lejon më së miri shtegtimet e largëta nga Afrika e Jugut ku dimërojnë, për të ardhur si vizitorë të verës te ne, kryesisht në periudhën maj-gusht. Gargulli ushqehet me insekte të mëdha, të cilat i zë në fluturim. Pasi kërkon për zona të hapura me peizazhe të shumëllojshme, e ndërton fole në shpate lumenjsh. Folezon në koloni dhe lëshon 6-7 vezë. Në Shqipëri është e rrezikuar nga gjuetia, edhe pse e ndaluar.

Pulëbardha këmbëverdhë juvenile *Larus michahellis*

REZERVA NATYRORE KUNE-VAIN

Pulëbardha këmbëverdhë juvenile, një shpend i këndshëm për pamjen e tij ku dallon sqepi i shkurtër dhe i trashë me një njollë të kuqe të madhe afër majës së sqepit. Me gjatësi 52-67 cm dhe gjatësi të hapjes së krahëve 130-158 cm, pulëbardha këmbëverdhë gjallon në bregdet dhe mjedise të tjera ujore. Folezon në tokë, por edhe në çati e shkëmbinj, ku lëshon 2-3 vezë. Ushqehet me parruazorë, peshq dhe mbetje ushqimore. Jetesa e këtij shpendi fatmirësisht është e pakërcënuar në Shqipëri, le ta sodisim bukurinë e tij.





Gushëkuqi ***Erithacus rubecula***

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Gushëkuqi është shpendi më i vogël në Evropë. Me gjatësi trupore 12-14 cm dhe gjatësi të hapjes së krahëve 20-22 cm, habitatit i tij janë pyjet gjethegjërë, të përzier dhe me shkurre të dendura, parqe dhe kopshte urbane. Ky zog interesant, i cili jo rrallëherë vjen në krijime artistike jo vetëm për sa i përket pamjes, por edhe zërit melodioz, në Shqipëri është jo shtegtues. Gjatë dimrit lëviz drejt zonave më të ulëta ku ndërton foletë në të çara muresh, shkurre të dendura dhe lëshon 4-6 vezë. Ushqehet me insekte dhe krimba të vegjël. Në Shqipëri është një specie e parrezikuar.





Rezerva Natyrore Kune-Vain



Skifteri kthetraverdhë

Falco naumani

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Skifteri kthetraverdhë është i vogël e mjaft elegant. Mashkulli i këtij shpendi dallohet nga gjoksi dhe barku i kuqërremtë, shiritat blu në gri në pjesën e sipërme të krahut, shpina e kuqërremtë dhe pjesa e mbulesës së sipërme të krahut e papikëluar. Një pamje që të kënaq me bukurinë karakteristike. Femra ka bisht kafe me shirita të errët. Gjatësia mesatare e skifterit kthetraverdhë shkon 27-33 cm dhe gjatësia e hapjes së krahëve 63-72 cm.

Është një shpend shtegtues, i cili dimëron në Afrikë, ndërsa në Shqipëri haset kryesisht gjatë shtegtimit në tufa të mëdha. Shumohet në koloni, mbi ndërtesat e qyteteve, në shkëmbinj, rrëpira, rrënoja etj. Ushqehet me insekte të kapura në tokë. Edhe pse në mbrojtje, në vendin tonë është një gjallesë e rrezikuar.



Drenja e përhime *Chalandrella brachydactyla*

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Drenja e përhime dallon nga drenjat e tjera nga trupi, të cilin e ka më të vogël. Gjithashtu, ndryshe nga drenjat e tjera, te ky shpend vihet re mungesa e pikave në qafë dhe në gjoks, por edhe njolla në anët e gjoksit. Është një shpend i vogël, me gjatësi trupore 14-16 cm dhe gjatësi e hapjes së krahëve 30 cm. Habitati i drenjës së përhime janë stepat dhe kullotat me bar të shkurtër ku ushqehet me insekte dhe fara. E parrezikuar në Shqipëri, kjo specie i ndërton foletë në tokë dhe lëshon 3-4 vezë, prej të cilave çelin zogjtë gjatë periudhës maj-korrik.

A photograph of a Starling (Sturnus vulgaris) standing on a patch of green grass. The bird is shown in profile, facing right, with its long, pointed beak touching the ground. Its feathers are dark with numerous white spots, particularly on the wings and back. The background is a soft-focus field of grass.

Shtura ose Cerloi i zi pikalosh *Sturnus vulgaris*

REZERVA NATYRORE KUNE-VAIN

Cerloi i zi pikalosh ose Shtura gjendet në habitate të hapura. Zakonisht gjallon në zona të hapura rurale, kullota, livadhe dhe toka bujqësore, pyje të rralluara dhe zona urbane. Kureshtje te ky shpend nxisin të rinjtë, tërësisht të zinj dhe me një shkëlqim që bie në sy menjëherë sapo e has. Gjatësia e trupit të shturës është 19-22 cm dhe gjatësia e hapjes së krahëve është 37-42 cm. Folezon në vrima pemësh, në të çara shkëmbinjsh, në vrima të hapura në tokë. Kur gjen terrenin e përshtatshëm, lëshon 4-7 vezë. Duke mos qenë një shpend në kërcënim zhdukjeje, mund të vizitohet në rezervën e Kune-Vainit.



Çafka e përhime *Ardea cinerea*

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Si ta dalloni çafkën e përhime? Lehtësisht. Shpinën e ka gri, gjoks dhe fyt të vijëzuar në të zezë. Gjatësia e trupit është 84-102 cm dhe gjatësia e hapjes së krahëve është 155-175 cm. Haset buzë ujërave, nga pellgjet më të vogla ose kanalet, deri në liqenet më të mëdha, madje edhe në breg të detit. Folezon në koloni, me fole të vendosura në majë të pemëve, ndonjëherë në shkurre të ulëta ose në tokë kur pemët mungojnë. Lëshon 2-3 vezë. Ushqehet kryesisht me peshq, veçanërisht ngjala. Në rrezik shihet ky shpend, edhe pse në mbrojtje.



Kalorësi

Himantopus himantopus

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Kalorësi është një shpend tepër elegant, me sqep të drejtë e të mprehtë si gjilpërë, këmbë mahnitëse, pak të kuqe në rozë, me puplim bardhë e zi. Me trup 35-40 cm të gjatë dhe gjatësi të hapjes së krahëve 67-83 cm, viziton zona me ujëra të ëmbla ose të kripura, si laguna, liqene të kripura, grykëderdhe lumenjsh dhe delta lumore. Dimëron në Afrikë. Në Shqipëri haset më tepër në zonën bregdetare të Adriatikut. Foletë i ndërton brenda ujit, herë pas herë pranë një grumbulli bimësie në ujë të cekët. Ushqehet me kryesisht me insekte. Edhe pse në mbrojtje, në vendin tonë është një gjallesë e rrezikuar.




Qyrylyku i vogël *Actitis hypoleucos*

KRIPORJA NARTË

Qyrylyku i vogël njihet prej ngjyrave karakteristike. Shpinë të kaftë dhe bark të bardhë, me një njollë të bardhë në fillim të krahut. Nuk i kalon 20 cm dhe hapja e krahëve shkon 32-35 cm. Haset përgjatë fluturimit në brigjet e gurta dhe ranore të lumenjve. Folenë e ndërton në sipërfaqe të tokës. Lëshon 4 vezë. Ushqehet me insekte dhe larvat e tyre, krimba dhe molusqe.

Është një shpend i parrezikuar në vendin tonë.





Dallëndyshe, Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta



Dervishi

Galerida cristata

REZERVA NATYRORE KUNE-VAJN

Dervishi është një nga haraberorët më të zakonshëm në peizazhet tona, sidomos gjatë dimrit. Puplumi në ngjyrë kafe me shirita të zinj në kurriz dhe kraharor është tërheqës, duke e pasuruar edhe më natyrën bregdetare ku zakonisht fluturon gjatë dimrit, ndërsa verës ngjitet në lartësi. Ky shpend i vogël, rreth 17 cm e ka gjatësinë e hapjes së krahëve 29-38 cm. Dervishi zgjedh t'i ndërtojë foletë në tokë, në terrene të hapura ose në shkurre gjatë periudhës prill-qershor. Ushqehet me insekte dhe fara. I gjendur më së shumti në rezervën Kune-Vain, është një shpend në rrezik. E detyrueshme të mbrohet si një pasuri natyrore.



Gardalina *Carduelis carduelis*

LAGUNA E ORIKUMIT

Gardalina, një shpend ku kanë gjetur frymëzim jo pak autorë veprash artistike, është i vogël, por mjaft i këndshëm. Gardalina shtegton në vende të ndryshme: në Evropë, në Azinë Perëndimore dhe përreth vendeve që kanë pyje fletëgjërë. Mashkulli dallohet nga femra sepse është më i gjatë, sqepin gjithashtu e ka më të gjatë dhe ngjyra e kuqe që ka në fytyrë e kalon pjesën e syrit. Kurse femra është trupvogël, ka një sqep të shkurtër dhe ngjyra e kuqe që ka në fytyrë nuk e kalon pjesën e syrit. Është një shpend me gjatësi 12-13 cm dhe gjatësi të hapjes së krahëve 21-25 cm. Gardalina folezon në pemë. Lëshon 5-6 vezë. Ushqehet me fara të bimëve të ndryshme. E pakërcënuar nga zhdukja, mund ta vizitosh jo pak në Shqipëri.



Bishtëbardha e gurit *Oenanthe oenanthe*

KRIPORJA NARTË

Mashkulli i këtij shpendi dallohet prej një vijëzimi të zi që i zgjatohet deri në një pjesë të faqes. Krahët i ka tërësisht të zinj, me kufi të dallueshëm prej shpinës gri. Femra është e ngjashme me mashkullin, por diferencohet nga puplaja, e cila është më e lehtë. Gjatësia mesatare shkon 14-16 cm dhe gjatësia e hapjes së krahëve 26-32 cm. Fluturon në zona të hapura gurishtore, kullota me pranë gurësh, ndërtesa gjysmë të rrënuara. Folenë e ndërton në tokë, midis gurëve, në të çara shkëmbinjsh, ose në ndërtesa gjysmë të rrënuara. Lëshon 5-6 vezë dhe ushqehet me insekte. Konsiderohet një shpend i parrezikuar në vendin tonë.



Vrapuesi i vogël *Charadrius alexandrinus*

KRIPORJA NARTË

Vrapuesi i vogël, pakëz më i vogël se vrapuesi i madh, ka këmbë të gjata, sqep të hollë dhe të errët. Përgjatë verës mund t'i vësh një si unazë të artë rreth syrit, ndërsa në fluturim i duken shiritat e hollë të krahëve. Nuk e kalon gjatësinë 15-18 cm, kurse gjatësia e hapjes së krahëve shkon te 32-35 cm. Në Shqipëri vjen në pranverë, qëndron gjatë verës, kur edhe folezon, më pas largohet në vjeshtë për në Afrikë. Haset zakonisht në brigjet e cekëta të detit dhe kripore. Foletë i bën në tokë, ku lëshon 4 vezë. Ushqehet me insekte që i kap në fluturim. Është një shpend i parrezikuar në vendin tonë.



Larashi kurrizkuq juvenil *Lanius Collurio*

LAGUNA E ORIKUMIT

Larashi kurrizkuq juvenil ka shpinë të kuqërremtë dhe bark të zbehtë, koka është gri dhe ka një vijimëzim të gjerë të zi. Femra dhe të rinjtë e këtij shpendi janë të ngjashëm: bark të zbehtë, pikla në formë luspash, kokë gri në kafe, gjatësia e trupit është 16-18 cm dhe gjatësia e hapjes së krahëve është 24-27 cm. Zgjedh të fluturojë në kullota dhe livadhe me shkurre dhe pemë të veçuara, toka bujqësore dhe pyje të rralla, kurse follenë e ndërton me bar, myshk dhe pendë dhe e vendos në shkurre, lëshon 5-6 vezë. Është një shpend i parrezikuar në vendin tonë.



Ceku kokëzi, femra *Saxicola rubicola*

PARKU KOMBËTAR DAJT

Ceku kokëzi bie në sy pasi ka kokë të zeze dhe jakë të bardhë të dallueshme. Shpinën e ka të errët, ndërsa gjoksi dhe pjesa e sipërme e barkut është e kuqërremtë. Femra ka puplajë të ngjashme, por ka kokë ngjyrë kafe të mbyllur. Fluturon ndër kullota dhe livadhe me shkurre në zonat e ulëta dhe ato kodrinore. Folezon në tokë, ku lëshon 5-6 vezë. Ushqehet me insekte. Është një shpend i parrezikuar në vendin tonë.





Flamingo

Phoenicopterus roseus

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Flamingo është një ndër shpendët më të spikatur për shkak të kontrasteve midis ngjyrës rozë, të zezë dhe të bardhë. Shpesh e përdorur pamja e tij si imazh në dekorime të ndryshme pikërisht prej ngjyrave të bukura dhe qëndrimit interesant që shfaq. Mbrojtja e këtij shpendi në Shqipëri ka bërë që një numër i konsiderueshëm flamingosh të rishfaqen në lagunat tona.

Përmasat mesatare të flamingove janë 120-145 cm, duke u konsideruar si shpendë të mëdhenj, ndërsa hapja e krahëve, e cila shkon në 140-170 cm, është një shfaqje mbresëlënëse. Flamingo folezon në ishuj dhe brigje të ulëta. Ngre fole në pirqje me baltë ku çelin 1-2 vezë. Kjo specie kaq interesante jeton në cekëtina dhe ujëra të njelmëta.





Flamingo juvenile (*Phenicopterus roseus juvenil*), Rezerva Natyrore Kune - Vain



Karabullaku i vogël *Phalacrocorax pygmeus*

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

Ky shpend i vogël, por interesant ka si karakteristikë puplajën e zezë, me faqe të bardhë dhe me njollë të bardhë në kofshë. Të rinjtë janë të zinj në gështenjë, me gjoks dhe bark të zbardhur. Gjatësia mesatare e tij shkon 77-94 cm

dhe gjatësia e hapjes së krahëve 121-149 cm. Gjendet në mjedise të hapura ujore të pasura me peshk. Shumohet në koloni, kryesisht në pemë, ku lëshon 3-4 vezë. Ushqehet me insekte. Është një shpend i parrezikuar në vendin tonë.





Laguna e Nartës



Dallëndyshja e detit *Glareola pratincola*


LAGUNA E NARTËS

Dallëndyshja e detit, një nga shpendët më të dashur për pamjen piktoreske, ka trup të vogël, krahë të gjatë, sqep të shkurtër dhe çka e bën më interesant është bishti i bigëzuar. Gjatësia e trupit nuk i kalon 27 cm dhe gjatësia e hapjes së krahëve 60-65 cm. Dallëndyshja preferon terrenet e thata, me bimësi të ulët, zona të zhveshura, kallamishte, ndaj e hasim në Shqipëri kur vjen pranvera dhe largohet në vjeshtë, ku dimëron në Afrikë. Fole të ndërtuara në tokë të zhveshur, ku folezon në koloni. Lëshon 2-4 vezë. Ushqehet kryesisht me insekte, të cilat i kap në fluturim. Fatmirësisht, një shpend i mbrojtur që nuk rrezikon.

Kukuvajka *Athene noctua*

PARKU KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA

I vogël, trashaluç, me kokë të sheshtë në ngjyrë gështenjë të errët, me njolla të zbehta sipër, të vijëzuar nga poshtë. Po flasim për kukuvajkën, një shpend i kudondodhur, në toka bujqësore me shkurre të zhvilluara dhe me pemë të shpërndara, jo pak i njohur në vendin tonë. Për kë nuk e njeh, ka gjatësi 21-23 cm dhe gjatësi të hapjes së krahëve 50-56 cm. Kukuvajka e ndërton follenë në çati shtëpish, zgavra shkëmbore, vrima pemësh. Lëshon 5-6 vezë. Ushqehet me kryesisht me insekte, shpendë e gjitarë të vegjël. E parrezikuar gjallon në vendin tonë.





Skifteri kthetrazi *Falco tinnunculus*

LAGUNA E NARTËS

Skifteri kthetrazi ka si karakteristikë qëndrimin pezull në ajër, me krahë që i rreh shpejt ose që i dridhen lehtësisht sipas ndryshimeve të erës. Parapëlqen terrene të hapura, toka kënetore, moçale bregdetare dhe duna, toka bujqësore dhe parqe, zona urbane. Është i kudondodhur në Shqipëri. I ndërton foletë në rrëza shkëmbinjsh, në foletë e vjetra. Lëshon 4-5 vezë. Ushqehet kryesisht me minj fushash. Edhe pse i mbrojtur, në vendin tonë është një gjallesë e rrezikuar.





Bajza *Fulica atra*

REZERVA NATYRORE KUNE-VAIN

Bajza është një shpend që njihet lehtësisht nga puplaja, e cila ka ngjyrë gri, me kokë dhe grykë të bardhë dhe gjatësi 36-38 cm dhe gjatësi të hapjes së krahëve 70-80 cm. Jeton zakonisht në sipërfaqe të gjera ujore me fund bimor të pasur. Në dimër, tufat e bajzave mund t'i vërsh në rezervuare, liqene dhe gropa të mbuluara me ujë të zonës bregdetare dhe kontinentale. Për folezim kërkon strehë nëpër shkurret e dala sipër ujit apo kallamishte.

Fundi i marsit është periudha më e përshtatshme e folezimit, gjatë së cilës lëshon 6-9 vezë. Ushqehet me kërcëj të gjelbër dhe barishtore ujore, të cilat i siguron nga zhytja. Nuk është një specie që kërcënohet në Shqipëri, një arsye për ta hasur jo pak në vendin tonë.



*Empowered lives
Resilient nations*